



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TRREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. _____ Prot.

Data, _____, 2016

UDHËZIM

Nr. 3078, datë 18.4 2016

Për

Miratimin e tarifave tavan që do të përdorin Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe laboratorët e etalonëve kombëtarë, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9875, date 14.2.2008 "Për Metrologjinë", i ndryshuar, neni 63, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, Ministri i Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

UDHËZOJ:

1. Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, si dhe laboratorët e etalonëve kombëtarë, jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, përdorin tarifa jo më të larta sesa tavanet përkatëse për shërbimet metrologjike, të përcaktuara në Tabelat Nr. 1, Tabela Nr. 2 dhe Tabela Nr.3 të cilat janë pjesë e këtij Udhëzimi.
2. Personat Juridikë dhe Fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për kryerjen e shërbimeve metrologjike, të përdorin si tarifa tavan gjatë kryerjes së shërbimeve metrologjike të përcaktuara në autorizim, tarifa të njëjta si për subjektet vendase, ashtu dhe ato të huaja, që ushtrojnë veprimtari prodhimi ose shërbimi në Republikën e Shqipërisë.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij Udhëzimi Personat juridikë dhe fizikë të autorizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë, laboratorët e etalonëve kombëtarë jashtë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë për monitorimin e tyre.

MINISTER

MILVA EKONOMI




Tabela 1

TARIFAT TAVAN PËR VERIFIKIMIN PERIODIK TE MATËSAVE TË UJIT NE PRURJEN NOMINALE Q_n

- Deri ne 5 m³/h 650 leke/cope,
- Mbi 5 m³/h deri ne 50 m³/h 900 leke/cope,
- Mbi 50 m³/h deri ne 100 m³/h 1 050 leke/cope,
- Mbi 100 m³/h deri ne 200 m³/h 2 050 leke/cope,
- Mbi 200 m³/h deri ne 500 m³/h 5 150 leke/cope,
- Mbi 500 m³/h 10 300 leke/cope.

Tabela 2

TARIFAT TAVAN TE SHËRBIMIT PËR VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË CISTERNAVE RRUGORE (AUTOBOTEVE)

Nr.	Emërtesa	Tarifa (ne Leke)
1	deri ne 5000 dm ³	7000
2	mbi 5000 dm ³ deri 10000 dm ³	8000
3	mbi 10000 dm ³ deri 15000 dm ³	9200
4	mbi 15000 dm ³ deri 20000 dm ³	10000
5	mbi 20000 dm ³ deri 25000 dm ³	11000
6	mbi 25000 dm ³ deri 30000 dm ³	12000
7	mbi 30000 dm ³	13000

Për verifikimin e autoboteve (çisterna rrugore) me shumë ndarje, të ndara nga njëra-tjetra, kur verifikimi i ndarjeve bëhet në të njëjtën kohë, pagesës së kapacitetit të autobotit, i shtohet pagesa prej 50 % të verifikimit të vëllimit përkatës të çdo ndarje.

Tabela 3

TARIFAT TAVAN TE SHËRBIMIT PËR VERIFIKIMIN E VËLLIMIT TË VAGONÇISTERNA

Nr.	Emërtesa	Tarifa (ne Leke)
1	Vagoncisterna deri 25000 dm ³	16000
2	Vagoncisterna mbi 25000 dm ³	20000

Shënim: Tarifat tavan në tabelat e mësipërme janë në vlerë totale, përfshirë TVSH.

